



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë  
[info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org) – [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

E Mërkurë, 3 Nëntor, 2010

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHPALLI REZULTATET E VALËS SË 46 TË PRIVATIZIMIT

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të Valës së 46 të Privatizimit, shpalli fituesit e përkohshëm për Ndërmarrjet e reja, të tenderuara përmes metodës së Spin Off-it të Rregullt. Gjithsej 15 Ndërmarrje të Reja ishin në dispozicion për shitje.

Ofertat u pranuan në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve nga ora 10:00 deri në ora 12:00. Ceremonia e hapjes së ofertave dhe publikimi i rezultateve u zhvillua po ashtu në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, nga ora 12:30 deri në ora 14:00.

Dorëzimi i ofertave nga ana e ofertuesve, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve është bërë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të medieve dhe investitorëve të pranishëm.

Gjithsej janë pranuar 62 oferta, dhe vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 6.437,109 €uro.

Zëvendësdrejtoresha e AKP-së, znj. Mrika Tahiri njoftoi se deri më tani janë privatizuar 613 ndërmarrje të reja, prej të cilave 588 janë privatizuar përmes metodës së Spin Off-it të Rregullt, ndërsa 25 prej tyre janë privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special. “Nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore deri më tani janë grumbulluar 472 milionë €uro, ndërkaq nga procesi i likuidimit me shitje të asetëve të ndërmarrjeve janë grumbulluar rreth 30 milionë €uro”, theksoi Zëvendësdrejtoresha e AKP-së, znj. Tahiri.

Agjencia Kosovare e Privatizimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, në pritje të vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Zt.Ylli Kaloshi në [ylli.kaloshi@pak-ks.org](mailto:ylli.kaloshi@pak-ks.org)  
apo në 038 500 400 lokali 2006

Përsa i përket shpërndarjes së 20 %, Znj. Tahiri tha se Agjencia po vazhdon me miratimin e listave të punëtorëve dhe shpërndarjen e shumës së 20% të të hyrave për punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, bazuar në strategjinë për përshejtimin e ndarjes së 20%, të miratuar më parë nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. “Deri më tani nga fondi i privatizimit, punëtorëve të Ndërmarrjeve Shoqërore iu janë shpërndarë rreth 30 Milionë Euro”, theksoi ajo. Agjencia Kosovare e Privatizimit, është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose asetëve në investitorë privatë, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa. Agjencia Kosovare e Privatizimit ushtron funksionet dhe përgjegjësitë që ka në mënyrë plotësisht të pavarur dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e Kosovës.

## FUND